

SPECIFIKIME TEKNIKE

Skena

**‘QENDRA KOMBËTARE E KULTURËS PËR FËMIJË
DHE TEATRI I KUKULLAVE’**

XDGA iRI

Mars 2026

Contents

01. SKENA KRYESORE.....	6
MAKINERIA E SIPERME SKENIKE DHE SISTEMI ELEKTRO - INFORMATIK I MENAXHIMIT TE FUNKSIONALITETIT TE MAKINERISE SE SIPERME SKENIKE (NIVEL SIGURIE SIL 3).....	6
1.1 Makineri Skenike.....	6
Përbërja e bobinës së kablllos	6
Kavot e çelikut	6
Morsetat e kavove	6
Motori	7
Shufrat e varësës	7
Kapaciteti ngritës efektiv (3.5 kn)	7
Sistemi i emergjencës	7
Shpejtësia e ngritjes dhe uljes	8
Encoderi	8
Testi i kapacitetit ngritës	8
Zhurma dhe dridhjet.....	8
1.2 Sistemi i vincave të skenës dhe kontrolli i tyre	8
Standardet e aplikuara dhe legjislacioni	8
1.3 Kriteret e përgjithshme në lidhje me pjesët që do të përdoren	8
1.4 Parametra teknike.....	9
1.5 Panel elektro-informatik me nivelin e sigurise sil3 (sistemi qendror i operimit)	9
1.6 Kushtet e bllokimit/ mbylljes	10
1.7 Pajisja kompjuterike komanduese e sistemit te makinerive te siperme	10
1.8 Funksionet bazë.....	10
1.9 Programi kompjuterik	12
1.10 Struktura mbajtëse vertikale per makinerine skenike	12
1.11 Struktura metalike mbajtëse e instaluar ne tavan per fiksimin e karrukullave.....	12
1.12 Vinc portabël me zinxhir.....	13
1.13 Struktura mbajtëse alumini	13
1.14 Panel furnizimi dhe komandimi per vincat portabel me zinxhir	14
02 MEKANIKA E POSHTME E SKENES – PLATFORMAT SKENIKE (DYSHEMETE) E LEVIZSHME TE SKENES DHE SISTEMI ELEKTRO – INFORMATIK I MENAXHIMIT TE FUNKSIONALITETIT TE PLATFORMAVE SKENIKE TE LEVIZSHME (NIVEL SIGURIE SIL 3)	14
2.1 Specifikimet teknike	14
2.2 Reduktori	15
2.3 Fren elektro-mekanik I dopiuar.....	15

2.4 Aksi bashkues me xhunto me levizje 360°	15
2.5 Mekanizem levizes ne kolone me zinxhire per levizjen vertikale	15
2.6 Mekanizem levizes per udhezimin e levizjes horizontale	15
2.7 Sensor per njohjen e lartësive te levizjes gjate operimit.....	15
2.8 Encoderi.....	16
2.9 Mbrojta me kontakt me prekje	16
2.10 Struktura metalike	16
2.11 Sistemi I kontrollit kryesore dhe pajisja kompjuterike komanduese	16
03 SPECIFIKIME TEKNIKE FONIA	16
3.1 Boks model 1.....	16
3.2 Subwoofer	17
3.3 Struktura varjeje	17
3.4 Struktura mbajtëse.....	17
3.5 Amplifikator fuqie.....	17
3.6 Procesuesi i sinjalit digjital on board dhe kontrolluesi ne distance nepermjet programit informatic (software perkates)	17
04 SPECIFIKIME TEKNIKE TE TEKSTILIT TE SKENES	18
4.1 Perde ballore	18
4.2 Mekanizem levizes per siparin e motorizuar me dy shina bashke me aksesoret e montimit dhe te levizjes	18
4.3 Sipari	18
4.4 Mekanizem levizes per perdet anesore me pershtates te harkuar bashke me aksesoret e montimit dhe te levizjes.....	19
4.5 Perdet anesore	19
4.6 Kembet	19
4.7 Ndares	19
4.8 Mekanizem levizes me shina per sfondin bashke me aksesoret e montimit dhe te levizjes	19
4.9 Sfond	20
4.10 Pelhure e holle perdeshe (tyl)	20
4.11 Perde projektori	20
4.12 Tapet kercimi I levizshem + ngjitesit.....	20
4.13 Mekanizem per mbajtje dhe transportim tapeti	20
05 SPECIFIKIME TEKNIKE NDRIÇIMI SKENIK	21
5.1 Ndriçues skenik tip 1	21
5.2 Ndriçues skenik tip 2	21
5.3 Ndriçues skenik tip 3	21

5.4 Ndriqes skenik tip 4	21
5.5 Ndriqes skenik tip 5	22
5.6 Ndriqes skenik tip 6	22
5.7 Ndriqes skenik tip 7	22
5.8 Ndriqes skenik tip 8	22
5.9 Ndriqes skenik tip 9	22
5.10 Ndriqes skenik tip 10.....	23
5.11 Lente fresnel.....	23
5.12 Lente profil	23
5.13 Mikser Ndricimi 1 + Artnet	23
06 PLATFORMAT PORTABEL PER ZGJATIMIN E SKENES SALLA KRYESORE (ZONA E POLTRONAVE TE LEVIZSHEM)	24
6.1 Platforma portabel	24
07 TEKSTILI AKUSTIK NE AUDITOR (MBI RRESHTAT ANESORE).....	24
7.1 Shine me mekanizem levizes I motorrizuar per perdet akustike ne auditor	24
7.2 Perde akustike ne auditor	24
08 POLTRONAT E AUDITORIUMIT	25
8.1 Poltrona auditor	25
8.2 Poltrona per llozhat	25
SALLA MULTIFUNKSIONALE.....	25
09 PAISJET AUDIO PER SALLEN KRYESORE + AUDITORIN MULTIFUNKSIONAL	25
9.1 Mikser zeri dixhital	25
9.2 Stage box per instalim ne rack	25
9.3 Lexues dhe regjistruer audio kasetash / CD / USB	26
9.4 Kompjuter monitore	26
9.5 Monitore zeri (kthyes).....	26
9.6 Monitore zeri (kthyes).....	26
9.7 Kufje per monitorim	26
9.8 Sistem marres digjital valor me 2 kanale	27
9.10 Antene per sistemet marrese valor.....	27
9.11 Mikrofon dore valor	27
9.12 Transmetues trupor valor	27
9.13 Mikrofon (head set)	28
9.14 Zerat vijues te preventivit	28
9.15 Zerat vijues te preventivit	28
10 INFRASTRUKTURA E SKENOGRAFISE SKENIKE.....	28

10.1 Vinc portabel me zinxhir.....	28
10.2 Struktura mbajtëse.....	28
10.3 Panel furnizimi dhe komandimi për vincat portable me zinxhir	29
11 TRIBUNAT TELESKOPIKE TE PALOSSHME DHE TE LEVIZSHME.....	29
11.1 Tribuna (shkallare) për spektatorët	29
12 SPECIFIKIME TEKNIKE FONIA	30
12.1 Boks model 1	30
12.2 Subwoofer model 1	30
12.3 Subwoofer model 2	30
12.4 Struktura	30
13 PERDET SKENOGRAFIKE DHE AKUSTIKE TE AUDITORIUMIT (SALLA MULTIFUNKSIONALE) SIPAS NDARJES SE AMBJENTEVE	30
13.1 Shinat për të gjitha ambjentet skenike	30
13.2 Perdet për të gjitha ambjentet skenike.....	31
14 PEDANA TE LEVIZSHME PËR FORMIMIN E SKENAVE NE AMBJENTET E AUDITORIT	31
14.1 Set kornize	31
PERDET E AMBJENTEVE TE TJERA.....	31
15 PERDET E AMBJENTEVE TE TJERA.....	31
15.1 Shinat për të gjitha ambjentet e tjera.....	31
15.2 Perdet për të gjitha ambjentet e tjera	31

01. SKENA KRYESORE

MAKINERIA E SIPERME SKENIKE DHE SISTEMI ELEKTRO - INFORMATIK I MENAXHIMIT TE FUNKSIONALITETIT TE MAKINERISE SE SIPERME SKENIKE (NIVEL SIGURIE SIL 3)

1.1 Makineri Skenike

Përbërja e bobinës së kabllos

Bobina duhet prej çeliku e farkëtuar e cilësisë së lartë, dhe tub të trashë të pandërprerë çeliku ose alumini. Përmasa dhe zona e kanaleve të kabllos duhet të jenë të njëjtë me gjerësinë e kavos së përdorur dhe në përputhje me specifikimet përkatëse. Kanalet e kabllos në bobinë duhet të jenë mjaft të thella në mënyrë që kavoja të mbështillet plotësisht brenda bobinës.

Për çdo kavo të mbështjellë në bobinë duhet të ketë të paktën dy të tjera rezervë (gjithmonë të lira në bobinë) dhe një hapësirë të lirë prej të paktën dy kanalesh në fund të bobinës ose në fillim të mbështjellës tjetër. Skajet e kavove janë të lidhura fort tek bobina. Të gjitha bobinat dhe kanalet janë të pajisura me një sistem i cili ndalon daljen e kavos nga kanalet.

Kavot e çelikut

Kavot janë prej fijesh të përdredhura çeliku dhe bërthame të thurur fibre. Të gjitha kavot janë të galvanizuar me zhytje të nxehtë me një trashësi të përcaktuar dhe do të dorëzohen në përputhje me kriteret e prodhuesve më të rëndësishëm ndërkombëtar.

Trajtimi në vend: Kavot do të trajtohen me kujdes dhe nuk do të ngatërrohen apo dëmtohen në asnjë rast. Kavot e dëmtuara apo të shtrembëruara nuk do të pranohen. Të gjitha pjesët e prera fundore do të trajtohen saktësisht.

Montimi : Gjatë operimit normal të pajisjes, kavot nuk duhet të fërkohen ndaj pjesëve statike apo të lëvizshme të pajisjeve të montuara. Kavot janë mbrojtur në vendet ku ka mundësi dëmtimi. Kavot lëvizëse që përdoren për tërheqje apo lëvizje, janë të mbrojtura aty ku është e nevojshme për të ofruar siguri ndaj personelit. Pas montimit, kontraktori do të kontrollojë nëse të gjitha lidhjet e kavove janë të sigurta.

Gjatë vendosjes së kavove, duhet të sigurohet që ato të kenë drejtimin e duhur të rrotullimit sipas drejtimit mbështjelljes së tyre në bobinë.

Morsetat e kavove

Të gjitha morsetat janë të galvanizuar dhe shoqërohen me certifikatën e testit të ngarkesës dhe certifikatën e cilësisë. Përmasa e morsetës korrespondon me diametrin e kavos. Në pjesët ku kavot janë të siguruara me morseta në forme U-je, të përdoren të paktën tre të tilla të montuara në mënyrë korrekte. Në rastet e përdorimit të kapëseve tërheqëse/shtrënguese, dadot frenuese duhet të shtrëngohen. Kur përdoren kapëset, ato duhet të shtrëngohen me prese hidraulike.

Motori

Lloji i motorit: Për makineritë e skenës të përdoren elektromotorë të mbyllur. Faktori i fuqisë: faktorët e fuqisë së motorëve janë më të medhenj se/ose të barabartë me 0.85.

Sistemi i frenimit elektro-mekanik

I gjithë sistemi i frenimit është me siguresa. Frenat mund të ngadalësojnë ngarkesën maksimale në kohën e përcaktuar dhe të mbajnë pajisjen të ndaluar. Frenat janë me disk, me tamburo ose me rrëshqitje, dhe vazhdojnë të funksionojnë në të gjitha rrethanat, dhe performanca e tyre nuk do të përkeqësohet nga dridhjet apo konsumimi.

Sistemi i frenimit përbëhet nga dy nofulla freni, ku secila prej tyre mund të mbajë ngarkesën e plotë.

Furnizimi me energji i frenave: për të zvogëluar zhurmat dhe për të rritur sigurinë, frenat ushqehen nga elektriciteti me rrymë të vazhdueshme.

Çaktivizimi manual: të gjitha frenat janë pajisur me çaktivizues manual. Nëse nuk ka indikator automatik, mund të shihet lehtësisht që freni është i çaktivizuar.

Akset universal

Akset universale duhet të kenë dimensione të tilla që nuk lejojnë përdredhjen. Akset universale sigurohen tek bobinat e kavove me anë të një bashkuesi universal.

Shufrat e varësës

Shufra përbëhet nga një ose dy tuba çeliku të mbivendosura, me diametër ≤ 50 mm dhe spesor ≥ 2 mm.

Bashkimi i tubave rrethore për së gjati do të behet me një tub të brendshëm i cili ka diametër të jashtëm jo më pak se 41 mm dhe trashësi të murit anësor prej 3 mm.

Tubi i brendshëm futen jo më pak se 20 cm brenda tubave që do të lidhen me njëra-tjetrën, duke përdorur elektodat e saldimit përmes djegies së tubit të jashtëm dhe të brendshëm të cilat saldohen së bashku.

Tubat e mbivendosura lidhen me njëra-tjetrën me pllaka çeliku. Tubi që do të futet mund të fiksohet me anën e një buloni me krahë M12 ose një bulon me manopol M12 e cila do të montohet tek tubi i shufrës me anën një buloni të salduar mbi tub.

Kapaciteti ngritës efektiv (3.5 kn)

Kapaciteti ngritës i kërkuar i varësës është kapaciteti i ngarkesës së nevojshme pa peshën e vetë varësës dhe kavove. Toleranca e kapacitetit ngritës neto është 10 % .

Sistemi i emergjencës

Projektimi i sistemit të emergjencës është i sigurt dhe në përputhje me standardet e aplikuara. Kur sistemi emergjencës aktivizohet, çdo pajisje në skenë apo makinerinë e motorizuar (përveç rastet kur përjashtohet shprehimisht) do të fiket dhe do të ndalojë shpejt dhe në mënyrë të sigurt.

Butoni i ndalimit emergjent është një buton i madh i kuq ndalimi me mekanizëm shtypjeje dhe rrotullimi, ndërsa qarku i ndalimit emergjent mund të aktivizohet në çdo moment duke shtypur këtë buton. Butoni i ndalimit emergjent vendoset në një vend nga ku operatori mund të shikojë nëse pajisja mund të rrezikojë stafin, dhe në një vend ku ky buton është i

dukshëm dhe i arritshëm, apo në një vend i cili mund të arrihet lehtë me dorë.

Sistemi i ndalimit emergjent mund të çaktivizohet me anë të lëshimit të butonit të emergjencës apo më anë të ndonjë butoni tjetër të përcaktuar. Sistemi i operimit është projektuar i tillë që çaktivizimi i sistemit të emergjencës nuk fillon lëvizjen e pajisjeve të tjera. Të gjitha pajisjet qëndrojnë të fikura deri kur ato ndizen manualisht ashtu si gjatë rutinës normale të operimit.

Gjithashtu, çdo sistem ndalimi emergjent si dhe për funksione të tjera sigurie duhet të ofrohet një informacion reagues (feedback) i cili bën të mundur shfaqjen e saktë të çdo kodi gabimi në kompjuterin e kontrollit (ose në një tregues vizual të vendit) bashkë me shkakun e aktivizimit të stakimit emergjent (apo të ndonjë funksioni tjetër sigurie).

Shpejtësia e ngritjes dhe uljes

Shpejtësia maksimale është 1.2 m/sek.

Encoderi

Do të bëjë të mundur monitorimin e pozicionimit të platformës dhe të dërgojë informacion në lidhje me statusin teknik të pajisjes.

Testi i kapacitetit ngritës

Prova e kapacitetit ngritës do të bëhet sipas SFS 4261 dhe DIN 56921-11. Varëset ngarkohen me maksimumin e peshës. Për testin e frenimit, varëset ngarkohen 25% mbipeshë.

Zhurma dhe dridhjet

Gjatë projektimit të pajisjeve mekanike duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë zhurmës dhe të merren masat e nevojshme për kufizimin e saj.

1.2 Sistemi i vincave të skenës dhe kontrolli i tyre

Standardet e aplikuara dhe legjislacioni

Instalimi i mësipërm duhet të kryhet në përputhje me ligjin ndërkombëtar, në veçanti, në përputhje me standardet IEC, EN dhe standardet kombëtare (NBN). Në rast konflikti, standardet ndërkombëtare prevalojnë mbi ato kombëtare (NBN ose të tjera). Përveç standardeve dhe ligjeve të sipër përmendura, projektimi, prodhimi, testimi dhe pranimi i pajisjeve të skenës do të plotësojnë (jo në mënyrë ekskluzive) standard në lidhje me pajisjet e teatrit, dhe standarde të tjera të përgjithshme ndërkombëtare.

1.3 Kriteret e përgjithshme në lidhje me pjesët që do të përdoren

Prodhimi i pjesëve dhe elementeve të montimit duhet të jetë i cilësisë së lartë. Aktivitetet si prodhimi, përpunimi, saldimi, montimi, instalimet elektrike, testimi dhe të tjera, bëhen nga specialistë të trajnuar dhe të kualifikuar.

Makineria duhet të mirëmbahet lehtësisht. Të gjitha pjesët mekanike dhe elektrike mund të kontrollohen dhe riparohen pa pasur nevojë të çmontohet e gjithë makineria. Do të përdoren etiketa (të pajisura me kode të cilat mundësojnë që çdo lidhje të jetë korrekte). Pjesa e furnizimit dhe drenazhimit të vajit në kutinë e shpejtësisë janë lehtësisht të arritshme. Nuk është e nevojshme të çmontohen pjesë që të behet kontrolli i nivelit të vajit, lubrifikimi apo ndërrimi i tij. Të gjitha kabllo dhe zinxhirët e çelikut janë të testuar në të

gjithë gjatësinë e tyre. Të gjitha pjesët e dëmtuara mund të zëvendësohen pa pasur nevojë të çmontohen pjesët nën ngarkesë. Kur ndërrohen pjesët, pjesëte tjera nuk dëmtohen. Testimi dhe mirëmbajtja e makinerisë nuk kërkon vegla të veçanta.

Sistemi mekanik dhe ai elektrik të ndërtohet në mënyrë që të gjitha pjesët dhe përbërësit mund të operojnë në kushte nominale (ngarkesë dhe shpejtësi nominale), dhe mund të punojnë pa probleme brenda një limiti shpejtësie, pa zhurmë. Zhurma e emetuar është brenda standardeve.

Kapaciteti i ngarkesës i përfshirë në kriteret dhe specifikimet teknike është ngarkesa efektive pa përfshirë peshën e pajisjes dhe pjesëve të saj. Të gjitha pajisjet dhe përbërësit përputhen me ligjet e sigurisë dhe me rregulloret e operimit që ofrojnë ambiente të sigurta për punonjësit që operojnë dhe mirëmbajnë këto pajisje. Të gjitha pjesët janë pajisur me sistem ndalimi emergjent, i cili i mundëson çdo punonjësi në afërsi ta ndalojë lehtësisht lëvizjen e pjesëve në rast aksidenti ose parandalimi të ndonjë aksidenti të mundshëm. Butoni i emergjencës është vendosur në panelin e kontrollit në një pozicion që do të përcaktohet. Të gjitha pjesët lëvizëse dhe rrotulluese të pajisjes që janë në afërsi të pozicionit të operimit të pajisjes janë të mbrojtura. Përveç butonit të sigurisë, të gjitha pajisjet duhet të kenë një çelës mbingarkese ose siguresë për të shmangur grumbullimin e kabllor në mbështjellës.

1.4 Parametra teknike

Sistemi është projektuar për një ngarkesë të shtangetës jo më pak se 530 kg, duke siguruar performancë të qëndrueshme dhe të sigurt gjatë operimit. Gjatesia e lëvizjes arrin deri në 12 metra, me një shpejtësi funksionimi prej 1.2 m/s, çka garanton efikasitetin në transportin vertikal ose horizontal të ngarkesës. Pajisja është e pajisur me një bobinë me diametër Ø320 mm, ndërsa përdor 6 kavo çeliku me diametër Ø6 mm secila, duke rritur qëndrueshmërinë dhe shpërndarjen e barabartë të ngarkesës. Motori ka fuqi 7.5 kW dhe operon me raport shpejtësie 19.7/72 rpm, duke gjeneruar një moment rrotullues prej 1440 Nm për funksionim të fuqishëm dhe të qëndrueshëm. Sistemi mundëson lëvizje në dy drejtime dhe është i pajisur me frena të fiksuara për siguri dhe kontroll maksimal gjatë punës.

- Ngarkesa e shtangetes(kg): jo më pak se 530 kg
- Gjatesia e lëvizjes: 12m
- Shpejtesia: 1.2 m/s
- Diametri i bobines: Ø320 mm
- Diametri i kavos të çelikut: Ø6 mm
- Numri i kavove të çelikut: 6
- Fuqia motorit: 7.5 kW
- Raporti i shpejtësisë: 19.7/72 rpm
- Momenti rrotullues: 1440Nm
- Të tjera: Lëvizje me dy drejtime, frena të fiksuara

1.5 Panel elektro-informatik me nivelin e sigurisë sil3 (sistemi qendror i operimit)

Sistemi i operimit duhet të jetë në përputhje me standardin IEC 62061 SIL3, duke garantuar nivel të lartë sigurie funksionale, ku varëset nuk lejohen të lëvizin në asnjë rast kur persona ndodhen nën to. Ky sistem mundëson drejtimin dhe kontrollin e plotë të operimit dhe gjendjes së të gjitha shtangetave në teatër, ndërsa ndërfaqet dhe metodat operacionale janë të përcaktuara në mënyrë të tillë që të sigurojnë mbrojtjen maksimale të pajisjeve dhe

stafit. Gjithashtu, janë parashikuar masa të posaçme për mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve, duke garantuar funksionim të qëndrueshëm dhe të sigurt në çdo kohë. Sistemet e operimit sigurojnë kontroll të besueshëm të shtangetave dhe përmbushin të gjitha kriteret e nevojshme për operimin e tyre gjatë ngarkesave, provave teknike dhe performancave skenike.

1.6 Kushtet e bllokimit/ mbylljes

Një mbyllje e sigurt dhe e besueshme instalohet në varëse për të garantuar sigurinë e personelit dhe pajisjes. Butonat e emergjencës janë kusht i nevojshëm mbylljeje për sistemin. Duhet të sigurohen të gjitha kushtet e mbylljes të jenë të përfshira në sistemin e operimit dhe të shfaqen në ekranin e panelit të kontrollit ose në ndonjë mënyrë tjetër. Një mbyllje e plotë behet nga programi i monitorimit, i cili siguron mbyllje të sigurt të pajisjes në funksionim.

1.7 Pajisja kompjuterike komanduese e sistemit të makinerive të siperme

Sistemi kryesor i komandimit përbëhet nga një sërë kontrollesh standarde të programuara ose rregullatorë aksesh si dhe lidhjet e rrjetit me kompjuterin.

Sistemi qendror i kontrollit mund të sigurojë të gjitha kontrollet e funksioneve në kushte normale, duke përfshirë kontrollin e pajisjeve individuale, mbylljen e pajisjeve, kontrollin e gjendjes së tyre, përzgjedhjen e pajisjes, vendosjen e parametrave të lëvizjes, veprimet në grup, kujtesën e dekorit, sekuencën e dekorit, diagnostikimin e gabimeve, mirëmbajtjen e sistemit, etj. Aktiviteti kryesor drejtohet në ekran, grafika dhe mënyrat tabulare të kombinuara me një tastierë me prekje me funksionin e përshtatshëm të ndërhyrjes manuale; sistemi gjithashtu pajiset me veprime fleksibël të kthimit, përsëritjes, kapërcimit dhe vazhdimësisë.

Për të përmbushur kriteret e ndryshme të kontrollit dhe operimit për dekorin, provat dhe performancën, pajisja e kontrollit të sistemit kryesor komandues është një kombinim i paneleve të kontrollit dhe joystick, të cilat përfshijnë të paktën: panelin kryesor të kontrollit dhe panel kontrolli i lëvizshëm për të ndjekur plotësisht lëvizjet e pajisjes në vende të ndryshme.

1.8 Funksionet bazë

Në gjendjen e pezulluar ose "ngarkuar", dekori duhet të jetë i lidhur me një pajisje mekanike, dhe të gjitha varëset në atë grup operohen njëkohësisht, në të njëjtën shpejtësi dhe të lëvizin në të njëjtën distancë. Për të shmangur gabimet, si rënien apo shtrembërimin e dekorit për shkak të shpejtësisë apo vendit të ndryshëm të pajisjes në grupin e mbyllur, sistemi do të jetë në gjendje të kontrollojë shpejtësinë dhe pozicionin e të gjitha pajisjeve në grup. Në rast se shpejtësia ose pozicioni i ndonjëres prej pajisjeve në atë grup është me e madhe sesa limiti i lejuar, sistemi duhet ta ndalojë pajisjen aktive në grup duke dhënë komandën "Ndalim emergjent - Emergency stop" .

Për të kontrolluar operimin e pajisjes së një grupi me kombinime komplekse shpejtësie, distance dhe parametrash të tjerë. Një kontroll i gabuar do të shkaktonte përplasje ose dëmtim të dekorit ose pajisjes. Sistemi përcakton një prioritet më të lartë dhe kontrollon

shpejtësinë dhe pozicionin e të gjitha pajisjeve në atë grup. Nëse ndonjë pajisje në grup nuk punon sipas një seti apo shpejtësisë të llogaritura, apo shpejtësia ose pozicioni devijon jashtë limiteve të përcaktuara, sistemi duhet të ndalojë kontrollin e pajisjes në atë grup duke dhënë komandën "Ndalim emergjent - Emergency stop" për të shmangur dëmtimin ose rrezikimin e dekorit.

Në rast se sekuenca e lëvizjeve të çdo pajisjeje në grup nuk i korrespondon mbylljes ose nëse ndodhin defekte tek cilado pajisje, sistemi duhet të ndalojë operimin e pajisjes në atë grup duke dhënë komandën "Ndalim emergjent - Emergency stop" për të shmangur dëmtimin ose rrezikimin e dekorit.

Për të organizuar operacione të kombinuara të më shumë se një pajisje që janë reciprokisht të pavarura dhe të përshtatshme për kontrollin e operacioneve të njëkohshme të më shumë se një pajisje që përdoren më shpesh gjatë shfaqjes. Grupi i lirë mundëson që pajisja, e cila është e pavarur nga pajisjet e tjera, të drejtohet sipas një seti të caktuar udhëzimesh vektoriale dhe veprimesh në distancë. Nëse shpejtësia ose pozicioni i secilës pajisje në këtë grup do të devijojë shumë jashtë kufijve të lejuar nga sistemi i operimit, sistemi do të japë komandën stop për këtë pajisje, ndërsa pajisjet e tjera nuk do të ndikohen dhe do të vazhdojnë operimin normal të tyre.

Vendosja e pozicionit të ndalimit

Operatori vendos paraprakisht 5 pozicione ndalimi nga 0-4 për çdo pajisje, e cila regjistrohet nga sistemi. Sistemi është pajisur me funksioni që lejon rregullimin e secilit pozicion ndalimi. Për pajisjet e ngritura ose të varura, dyshemeja e teatrit shërben si pikë referimi. Pozicioni i ndalimit mund të vendoset lehtësisht në panelin kryesor të kontrollit ose në pulset përkatëse.

Ndezja e pajisjes

Pajisja mund të ndizet me anë të një tastiere funksionale në përputhje me mënyrat paraprake të vendosura në ekran, grafik ose tabelë. Është e mundur që një pajisje ose një grup pajisjesh mund të ndizet me anën të një butoni apo leve në panelin kryesor të kontrollit. Pajisja më pas lëviz nga një pozicion paraprak ndalimi në një tjetër sipas shpejtësisë, kohës dhe parametrave të tjerë, ose lëviz nga një pozicion efektiv në një tjetër. Është e nevojshme që funksioni të vendoset në mënyrë manuale për të kontrolluar lëvizjen e pajisjeve në rast të një njësie të vetme, grupi pajisjesh, grupi të memorizuar dekori, ose një sekuenca dekori.

Shpejtësia e nënkuptuar

Nëse shpejtësia për një pajisje nuk është vendosur apo nuk është e mundur të vendoset, pajisja do të punojë me një shpejtësi të nënkuptuar. Kjo shpejtësi varion në bazë të llojit të pajisjes, dhe kontraktori do ta integrojë atë në projektim dhe në sistemin e operimit me anë të programit ose mekanizmave.

Funksione të tjera të nevojshme

Sistemi siguron funksione të përsosura kontrolli: memoria e pozicionit të varësive, ndryshimi i dekorit, lëvizja e varësive sipas kërkesave kur bëhet montimi i dekorit dhe dritave gjatë përgatitjes, provave dhe shfaqjes. Kontraktori siguron zgjidhje dhe procedura operimi të sofistikuara dhe të thjeshtuara duke u bazuar në eksperiencën e tij. Simulimi offline është i pajisur me efekt dinamik tre dimensional.

1.9 Programi kompjuterik

Zbatueshmëria : Programi duhet të jetë projektuar dhe zhvilluar specifikisht për kontrollin dhe operimin e varësive. Ai do të ketë një bashkëveprim të mirë njeri – makineri për një operim të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë, dhe do të ketë një sërë funksionesh, si kontrolli i ekraneve për shfaqjen grafike dhe digjitale të pamjeve, memoria automatike, funksioni i ndihmës online, identifikimi i gabime, lista e zgjidhjes së problemeve. Heqja në kohë dhe në mënyrë korrekte e tabelave informuese të kompjuterit është e nevojshme, po ashtu edhe llogaritja e vlerës së luhatshme të jetë e saktë dhe pa gabime. Sistemi është i qëndrueshëm dhe pa përcaktim kohe midis avarive (MTTF) siç përcaktohet në standardet industriale. Teknologjia e kontrollit dhe e programit është e avancuar.

Mjedisi i punës: programi kompjuterik i kontrollit duhet të zhvillohet në bazë të një sistemi kompjuterik të sigurt, të përshtatshëm dhe të besueshëm.

Gjuha : Versioni në gjuhën shqipe duhet të jetë në përputhje me nevojat e ndërfaqes së operatorit dhe konfigurimeve, etj., në mënyrë që programi të jetë lehtësisht i përdorshëm.

Menaxhimi i skedarëve të përdoruesit : Sistemi ndalon aksesin e operatorit në skedarët bazë të programit. Çdo skedar që është krijuar gjatë ngarkimit të programit është i mbrojtur me një kod. Inxhinieri mund të kontrollojë ose mund të ndryshojë rrugën e operimit.

Funksioni i regjistrimit të informacionit dhe printimit: Programi mund të ruajë dhe të printojë çdo operacion, kontroll e lëvizje, dhe interferencë në pajisje. Printimi dhe shfaqja në tabela do të jetë i qartë dhe çdo informacion i pasaktë do të jetë i dukshëm.

1.10 Struktura mbajtëse vertikale për makinerinë skenike

Strukturat mbajtëse do të kenë funksionin kryesor të sigurimit dhe pozicionimit të saktë të elektromotorëve në orientim vertikal, duke garantuar qëndrueshmëri dhe minimizimin e deformimeve gjatë funksionimit. Këto struktura do të jenë të ndërtuara nga pllaka çeliku me trashësi dhe rezistencë të përshtatshme, të dimensionuara në përputhje me ngarkesat statike dhe dinamike që ushtrohen mbi to.

Elementët përbërës të strukturës do të lidhen me njëri-tjetrin nëpërmjet saldimeve të kontrolluara ose bulonave me rezistencë të lartë, në përputhje me standardet përkatëse të ndërtimit metalik. Fiksimi në murin anësor do të realizohet përmes prizhonerëve të ankoruar thellësisht në strukturën mbajtëse të murit, duke siguruar një shpërndarje optimale të forcave të veprimit dhe eliminimin e mundësisë së lëvizjeve të padëshiruara ose vibracioneve të dëmshme.

Gjithashtu, do të kryhet një analizë e detajuar e kushteve strukturore të murit mbështetës për të vlerësuar kapacitetin mbajtës të tij, duke garantuar që ngarkesat e transmetuara nga elektromotorët dhe nga vetë struktura të mos tejkalojnë kufijtë e lejuar të sigurisë. Të gjitha dimensionimet dhe metodat e montimit do të jenë në përputhje me normat dhe standardet teknike të aplikueshme për instalimet mekanike dhe konstruksionet metalike.

1.11 Struktura metalike mbajtëse e instaluar në tavan për fiksimin e karrukullave

Strukturat metalike që do të montohen në tavan do të përbëhen nga elementë çeliku të dimensionuar sipas kërkesave të ngarkesave strukturore dhe në përputhje me normat inxhinierike të ndërtimit metalik. Këto struktura do të shërbejnë si elementë mbajtës për

fiksimin e karrukullave, të cilat do të mundësojnë drejtimin dhe lëvizjen e kavove të secilit elektromotor, duke siguruar një funksionim të qëndrueshëm dhe pa deformime të sistemit të ngritjes.

Pozicionimi i strukturave do të realizohet në mënyrë të tillë që të mbulojë të gjithë gjerësinë e skenës, duke garantuar që karrukullat të jenë të fiksuara në vijë të drejtë me elektromotorët për një shpërndarje të ekuilibruar të forcave tërheqëse dhe për të minimizuar devijimet gjatë ngritjes dhe uljes së ngarkesave. Gjithsej do të montohen tetë (8) struktura, të cilat do të ndahen si më poshtë:

Dy (2) struktura do të vendosen direkt mbi tamburet e elektromotorëve, duke siguruar mbështetje të fortë dhe të qëndrueshme për sistemin e lëvizjes së kavove.

Gjashtë (6) struktura të tjera do të pozicionohen mbi secilën pikë të kapjes së shtangetave, duke garantuar shpërndarjen e njëtrajtshme të ngarkesave vertikale dhe duke zvogëluar momentet e përkuljes mbi strukturën mbajtëse.

Montimi i strukturave do të realizohet me anë të lidhjeve mekanike të sigurta, duke përfshirë bulonime me forcë të lartë ose saldime të kontrolluara, në varësi të analizës strukturore dhe specifikimeve teknike të projektit.

Përpara fillimit të procesit të instalimit të elektromotorëve dhe karrukullave, kontraktori është i detyruar të ndërtojë projektin e detajuar strukturor, i cili duhet të përfshijë analizën inxhinierike të kapaciteteve mbajtëse të strukturës. Ky dokumentacion duhet të përmbajë llogaritjet e sakta të ngarkesave statike dhe dinamike, duke marrë në konsideratë forcat e veprimit gjatë funksionimit të elektromotorëve, dridhjet e induktuara dhe shpërndarjen e momenteve rrotulluese. Të gjitha këto analiza duhet të jenë në përputhje me normativat dhe standardet e aplikueshme të projektimit dhe sigurisë strukturore.

1.12 Vinc portabël me zinxhir

Vinçi portabël me zinxhir është projektuar për montimin e instalimeve skenografike dhe është i pajisur me sistem vetëngritjeje për lehtësi dhe siguri në përdorim. Ai ka një kapacitet ngritës jo më pak se 1000 kg dhe mund të arrijë një lartësi ngritjeje deri në 25 metra, me shpejtësi ngritjeje jo më pak se 3.8 m/s, duke garantuar efikasitet në operim. Pajisja është e pajisur me sistem frenimi të dyfishtë elektromagnetik, mbrojtje të motorit dhe mbrojtje nga mbingarkesa, si dhe mbrojtje ambientale IP55 për përdorim në kushte të ndryshme pune. Vinçi duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve CE dhe TUV, duke përmbushur kërkesat ndërkombëtare të sigurisë dhe cilësisë.

- Funksioni: Vinçat portabël do të shërbejnë për montimin e instalime skenografike dhe duhet të jenë me sistem vetëngritjeje.
- Kapaciteti ngrites: jo më pak se 1000 kg
- Lartësia e ngritjes: max 25 m
- Shpejtësia e ngritjes: jo më pak se 3.8 m/s
- Sistemi i frenimit: me fren të dyfishtë elektromagnetik
- Me mbrojtje të motorit dhe të mbingarkesë
- Me mbrojtje ambientale IP 55
- Certifikim CE dhe TUV

1.13 Struktura mbajtëse alumini

Struktura mbajtëse prej alumini (truss) përdoret në skenografi, ndriçim, evente dhe

instalime teatrore apo koncertale, duke ofruar qëndrueshmëri dhe fleksibilitet në konfigurim. Materiali i përdorur është alumin sipas standardit EN-AW 6082 T6, i njohur për rezistencën dhe peshën e lehtë. Struktura është e tipit katror me përmasa 29 x 29 cm, ndërsa gjatësia përcaktohet në varësi të konfigurimit të propozuar nga kontraktori. Sistemi përfshin aksesoret bashkues dhe elementët fundorë për montim të sigurt, dhe paraqitet në ngjyrë të zezë për përshtatje estetike me ambientin skenik.

- Funksionet: Truss-et skenografike janë struktura të përdorura kryesisht në skenografi, ndriçim, evente dhe instalime të ndryshme teatrore apo koncertale.
- Materiali: alumin sipas standardit EN-AW 6082 T6
- Tipi: Katror
- Dimensionet: Gjerësia 29 x 29 cm, Gjatësia: në varësi të konfigurimit që propozohet nga kontraktori.
- Përfshirë: Aksesoret bashkues dhe fundorë
- Ngjyra: e zeze

1.14 Panel furnizimi dhe komandimi për vintat portabel me zinxhir

Paneli i furnizimit dhe komandimit është projektuar si një njësi portabel për kontrollin e vintave me zinxhir, me përmasa maksimale 62 x 55 x 64 cm, duke e bërë praktik për transport dhe instalim. Ai është i pajisur me butona emergjence, tregues të furnizimit me energji dhe të statusit të punës, si dhe komanda për ngritje dhe ulje, duke garantuar kontroll të plotë dhe të sigurt gjatë operimit. Paneli mundëson kontroll të deri në 8 kanaleve, veçmas ose në mënyrë të njëkohshme, dhe përmbush standardet CE (IEC). Sistemi është i përshtatshëm për kapacitet ngritës maksimal deri në 1000 kg, duke siguruar funksionim të qëndrueshëm dhe të besueshëm në kushte skenike.

- Tipi: Panel furnizimi dhe komandues portabel
- Përmasat : jo më shumë se 62 x 55 x 64 cm
- Karakteristika të domosdoshme: Butonat e emergjencës, treguesit e ushqimit dhe të statusit të punës dhe të kontrollit të ulje / ngritjes si dhe ato energjisë dhe funksionimit
- Kapaciteti i kontrollit: 8 kanale vec e vec ose në mënyrë të njëkohshme
- Standardi CE (IEC)
- Kapaciteti ngritës: max 1000 kg

02 MEKANIKA E POSHTME E SKENES – PLATFORMAT SKENIKE (DYSHEMETE) E LEVIZSHME TE SKENES DHE SISTEMI ELEKTRO – INFORMATIK I MENAXHIMIT TE FUNKSIONALITETIT TE PLATFORMAVE SKENIKE TE LEVIZSHME (NIVEL SIGURIE SIL 3)

2.1 Specifikimet teknike

Furnizimi me 5 copë platforma, ku secila platformë ka një sipërfaqe prej 23 m². Platforma është projektuar të funksionojë me një shpejtësi lëvizjeje prej 0.05 m/s, duke përballuar një ngarkesë totale dinamike prej (2.5 + 1.5) kN/m dhe një ngarkesë totale statike prej (5.0 + 1.5) kN/m. Sistemi përfshin 1 ndalesë gjatë lëvizjes dhe mundëson një lartësi ngritjeje deri në 1.5 m. Funksionimi realizohet përmes një motori me fuqi 11 kW, ndërsa sistemi garanton toleranca pozicionimi me saktësi ±2 mm. Gjithashtu, platforma duhet të jetë e pajisur me sensorë tregues, të cilët përcaktojnë kufijtë maksimalë dhe minimalë të lartësisë sipas

niveleve të objektit, duke siguruar kështu funksionim të sigurt dhe kontroll të lëvizjes.

2.2 Reduktori

Komponenti mekanik përgjegjës për rregullimin e raportit të shpejtësisë, duke mundësuar uljen e shpejtësisë së rrotullimit të motorit dhe rritjen e çiftit rrotullues, çka lejon lëvizjen e platformës edhe në kushte të ngarkesave të rënda. Në këtë sistem parashikohen 6 pozicione të boshtit të daljes, të orientuara majtas (L) dhe djathtas (R), në varësi të konfigurimit të instalimit. Gjithashtu, reduktori është projektuar të funksionojë me një rreze lëvizjeje prej 40 mm, duke garantuar transmetim të qëndrueshëm të forcës dhe funksionim efikas të mekanizmit të ngritjes së platformës.

2.3 Fren elektro-mekanik I dopiuar

Element sigurie i projektuar për të parandaluar lëvizjen e platformës gjatë periudhave të pushimit ose në rastet kur është e nevojshme ndalimi i saj për arsye teknike. Ky sistem frenimi siguron stabilitet dhe mbajtje të sigurt të platformës edhe në kushte ngarkese. Freni mund të kontrollohet automatikisht nga sistemi i komandimit, duke garantuar funksionim normal gjatë operimit, por në raste emergjence ai mund të aktivizohet edhe manualisht, duke rritur nivelin e sigurisë dhe kontrollit gjatë përdorimit të pajisjes.

2.4 Aksi bashkues me xhunto me levizje 360°

Mundëson lidhje fleksibile midis motorit dhe reduktorit, duke siguruar transmetimin e qëndrueshëm të forcës nga motori drejt reduktorit. Ky komponent lejon përshtatjen e lëvizjeve dhe devijimeve të vogla gjatë punës, pa ndikuar në lëvizje të padëshiruara të pjesëve të tjera të sistemit. Përmes fleksibilitetit të tij dhe aftësisë për lëvizje në kënd të plotë, ai kontribuon në minimizimin e rrezikut të dëmtimeve në lidhjet mekanike, duke rritur besueshmërinë dhe jetëgjatësinë e mekanizmit gjatë funksionimit të platformës.

2.5 Mekanizem levizes ne kolone me zinxhire per levizjen vertikale

Sistem mekanik që siguron ngritjen dhe uljen vertikale të platformës në mënyrë të qëndrueshme dhe të kontrolluar. Në këtë mekanizëm, zinxhiri realizon lidhjen ndërmjet motorit dhe sistemit të udhëzimit, duke transmetuar forcën e nevojshme për lëvizjen e platformës. Ky konfigurim mundëson që platforma të ngrihet dhe të ulet me saktësi, duke garantuar që të gjitha pjesët e saj të lëvizin në mënyrë të sinkronizuar, të sigurt dhe të qëndrueshme gjatë gjithë procesit të funksionimit.

2.6 Mekanizem levizes per udhezimin e levizjes horizontale

Sistem mekanik i projektuar për të siguruar lëvizjen horizontale të platformës në mënyrë të qëndrueshme dhe të kontrolluar. Ky mekanizëm shërben për pozicionimin e saktë të platformës në skenë, duke mundësuar zhvendosjen e saj ndërmjet pozicioneve të ndryshme sipas nevojave të përdorimit. Falë këtij sistemi, realizohen kalime të shpejta, të sigurta dhe të koordinuara, duke garantuar funksionim efikas dhe stabilitet gjatë gjithë procesit të lëvizjes.

2.7 Sensor per njohjen e lartësive te levizjes gjate operimit

Komponent kontrolli dhe sigurie që monitoron pozicionin vertikal të platformës gjatë funksionimit. Platforma është e pajisur me sensorë tregues që përcaktojnë kufijtë maksimalë dhe minimalë të lartësisë, në përputhje me nivelet e objektit ku është instaluar. Ky sistem siguron që lëvizja e platformës të realizohet në mënyrë të kontrolluar dhe brenda limiteve të lejuara, duke garantuar kështu siguri të lartë gjatë operimit dhe duke parandaluar tejkalimin e pozicioneve të përcaktuara.

2.8 Encoderi

Pajisje matëse elektronike që përdoret për monitorimin e pozicionimit dhe lëvizjes së platformës gjatë operimit. Ai regjistron dhe transmeton të dhëna të sakta mbi pozicionin dhe drejtimin e lëvizjes, duke i dërguar këto informacione në sistemin e kontrollit. Në këtë mënyrë, encoderi mundëson mbikëqyrjen e vazhdueshme të funksionimit të platformës dhe siguron informacion të rëndësishëm mbi statusin teknik të pajisjes, duke ndihmuar në rritjen e saktësisë së operimit dhe në garantimin e sigurisë së sistemit.

2.9 Mbrojta me kontakt me prekje

Sistem sigurie që synon garantimin e funksionimit të sigurt të pajisjeve dhe mbrojtjen e përdoruesve gjatë operimit të platformës. Në këtë kuadër, elektromotorët duhet të jenë të pajisur me fllanxhë lidhjeje dhe dy boshte, si dhe të përfshijnë çelës sigurie ndaj mbinxhjes, me kategori mbrojtëse IP54 dhe regjim operimi S3-60%, duke siguruar qëndrueshmëri dhe mbrojtje ndaj faktorëve të jashtëm. Në rastet kur motorët nuk kanë mekanizëm vetë-frenimi, duhet të instalohen dy frena të pavarura nga njëra-tjetra, të afta për të përballuar momentin inertial të sistemit. Gjithashtu, projektimi i sistemit të friksionit duhet të realizohet pa xhoko, në formën e friksionit elektromagnetik, i cili mundëson transmetimin e forcës rrotulluese pa humbje dhe përshtatet me boshtet e transmisionit, duke garantuar funksionim të sigurt dhe efikas të gjithë mekanizmit.

2.10 Struktura metalike

Struktura metalike do të shërbejë si platformë mbështetëse dhe lidhëse ndërmjet 4 këmbëve (zinxhirëve mbajtës) të secilës platformë. Ajo është e përbërë nga trarë metalik sipas dy drejtimeve dhe sipër tyre do të vendosen binarë druri dhe sipër tyre paketa e shtresave, e cila duhet të jetë e njëjtë me atë të skenës që është bërë me përpara. Kjo strukturë do të mbështetet në 4 pika, ku janë pozicionuar motorët ngritës dhe ulës të saj.

2.11 Sistemi I kontrollit kryesor dhe pajisja kompjuterike komanduese

Sistemi kryesor i komandimit përbëhet nga një sërë kontrollesh standarde të programuara ose rregullatorë aksesh si dhe lidhjet e rrjetit me kompjuterin. Sistemi kryesor i komandimit duhet të komandojë një platformë ose dhe në të gjitha kombinimet e mundshme të pesta në të njëjtën kohë në distancë .

Aktiviteti kryesor drejtohet nëpërmjet panelit komandues, i cili përbëhet nga një ekran me prekje, joystick (leva fizike ose butona). Ndërsa në ekran shfaqen dhe komandohen, editohen, vizualizohen dhe ruhen parametrat dhe grafika dhe mënyrat tabulare të kombinuara me një tastierë me prekje me funksionin e përshtatshëm të ndërhyrjes manuale; sistemi gjithashtu pajiset me veprime fleksibël të kthimit, përsëritjes, kapërcimit dhe vazhdimësisë (duhet që të përdoret i njëjti ekran që do të përdoret për kontrollin dhe monitorimin e akseve të mbi-skenës).

Në rastin kur do të përdoret i njëjti ekran, atëherë konfigurimi duhet të jetë i sigurt që sistemet të mos ngatërrohen me njëri – tjetrin.

03 SPECIFIKIME TEKNIKE FONIA

3.1 Boks model 1

Boks Model 1 është një altoparlant pasiv me performancë të lartë, i pajisur me woofer 12"

me magnet ferrit 1" dhe compression driver, që siguron riprodhim të qartë dhe të fuqishëm të zërit. Me një fuqi prej 400 W, ky boks ofron performancë të qëndrueshme dhe të përshtatshme për ambiente të ndryshme. Ai ka një mbulim vertikal prej 30° dhe horizontal prej 90°, duke shpërndarë zërin në mënyrë efikase në hapësirë. Trupi i tij është i ndërtuar nga material inox, që garanton qëndrueshmëri dhe rezistencë, ndërsa ngjyra e zezë i jep një pamje elegante dhe profesionale.

3.2 Subwoofer

Subwoofer është një altoparlant pasiv i projektuar për riprodhimin e frekuencave të ulëta me performancë të lartë. Ai është i pajisur me 2x18", duke ofruar bas të thellë dhe të fuqishëm. Me një fuqi prej 3000 W dhe impedancë 4 Ω, ky subwoofer garanton efikasitet dhe performancë të qëndrueshme në sisteme profesionale audio. Ka mbulim Omni directional, që mundëson shpërndarje të barabartë të frekuencave të ulëta në të gjitha drejtimet. Përgjigjia e frekuencës 30 Hz – 150 Hz (-6 dB) siguron riprodhim të saktë të basit, ndërsa Max SPL prej 138 dB e bën të përshtatshëm për ambiente të mëdha dhe evente me kërkesa të larta të zërit.

3.3 Struktura varjeje

Element mbështetës i projektuar për montimin dhe varjen e bokseve të zërit në mënyrë të sigurt dhe profesionale. Ajo përdoret për të mbajtur dhe pozicionuar bokset në lartësi të ndryshme, duke siguruar shpërndarje më të mirë të zërit në ambient. Struktura është e ndërtuar nga material inox, i cili garanton qëndrueshmëri, rezistencë dhe jetëgjatësi në përdorim. Ngjyra e zezë i jep një pamje estetike dhe diskrete, duke u përshtatur lehtësisht me pajisjet e tjera të sistemit audio dhe me ambientin ku instalohet.

3.4 Struktura mbajtëse

Komponent i projektuar për mbajtjen dhe pozicionimin e bokseve të zërit në mënyrë të sigurt dhe të qëndrueshme. Funksioni i saj kryesor është të shërbejë si mbajtëse dhe graduese sipas llojit të boksit, duke mundësuar rregullimin e këndit dhe pozicionit për shpërndarje sa më efikase të zërit në ambient. Kjo strukturë ndihmon në instalim profesional dhe në optimizimin e performancës së sistemit audio.

3.5 Amplifikator fuqie

Pajisje profesionale audio e projektuar për të fuqizuar dhe përmirësuar sinjalin e zërit në sisteme të ndryshme akustike. Ky amplifikator është tip 4 kanale dhe përdor klasin D, i cili siguron efikasitet të lartë dhe konsum më të ulët të energjisë. Ai ofron një fuqi dalëse prej 4x1500 W me impedancë 4 Ω, duke garantuar performancë të fuqishme dhe të qëndrueshme për përdorim profesional. Pajisja është e ndërtuar nga material inox, që siguron qëndrueshmëri dhe rezistencë, ndërsa ngjyra e zezë i jep një pamje moderne dhe elegante që përshtatet lehtësisht me pajisje të tjera të sistemit audio.

3.6 Procesuesi i sinjalit digjital on board dhe kontrolluesi ne distance nepermjet programit informatic (software perkates)

Komponent i integruar në sistemin e fonisë që mundëson përpunimin, menaxhimin dhe optimizimin e sinjalit audio në mënyrë digjitale. Ky procesues lejon rregullimin e parametrave të ndryshëm të zërit, si balancimi, filtrimi dhe kontrolli i frekuencave, duke siguruar performancë optimale të sistemit audio. Gjithashtu, ai ofron mundësinë e kontrollit dhe menaxhimit në distancë përmes një programi informatik, duke e bërë përdorimin dhe konfigurimin më të thjeshtë dhe më efikas. Karakteristikat dhe funksionet e tij përcaktohen

sipas modelit dhe markës së fonisë së propozuar nga kontraktori.

04 SPECIFIKIME TEKNIKE TE TEKSTILIT TE SKENES

4.1 Perde ballore

Element i rëndësishëm skenik dhe funksional, e projektuar për të siguruar mbulim estetik, kontroll të akustikës dhe mbrojtje sipas standardeve të sigurisë. Ajo realizohet me material PES – FR 100%, me pasurim $\geq 50\%$, dhe me peshë jo më të vogël se 450 g/m^2 , duke mbuluar një sipërfaqe totale prej rreth 70 m^2 . Materiali duhet të plotësojë standardet e mbrojtjes nga zjarri dhe fërkimi, përfshirë klasën e rrjedhjes së materialit të ndezur NF P 92-507 / M1, klasën zjarrrduruese EN 13773 / 2003 dhe klasën e përhapjes së zjarrit NFPA 701 (pass), si dhe normativën e fërkimit ISO 12947-2:1998 ≥ 42000 cikle. Perdja është e qepur në të majtë dhe në të djathtë, ndërsa pjesa e sipërme përfshin shufër mbajtëse me ylyk dhe vrima lidhëse çdo 15–20 cm, duke mundësuar montim të qëndrueshëm. Në pjesën e poshtme parashikohet xhep me gjerësi 10 cm, i cili ndihmon në stabilitetin dhe formën e perdes gjatë përdorimit. Gjithashtu, materiali siguron koeficient të ponderuar të absorbimit të zërit $\alpha_w \geq 0.75$ (H), duke kontribuar në përmirësimin e akustikës së ambientit, ndërsa ngjyra e perdes zgjidhet sipas kërkesave të projektit.

4.2 Mekanizem levizes per siparin e motorizuar me dy shina bashke me aksesoret e monitmit dhe te levizjes

Sistem i projektuar për hollësisht kontrollimin e lëvizjes së siparit në skenë, duke siguruar funksionim të qetë dhe të qëndrueshëm. Ky mekanizëm ka model me shinë të dyfishtë, ku sistemi i lëvizjes realizohet përmes motorit dhe lëvizja kryhet me litar me përbërje plastike ose nailon, duke garantuar fleksibilitet dhe rezistencë. Shinat janë të prodhimit nga materiali alumin, me një gjatësi totale prej 14 m dhe ngjyrë e zezë me lyerje të anodizuar, për qëndrueshmëri dhe estetikë. Hapja e siparit është anësore, nga qendra drejt anëve, ndërsa shina e dyfishtë është e pajisur me gomina për shmangien e goditjeve dhe reduktimin e zhurmave, duke siguruar lëvizje të qetë. Montimi i sistemit bëhet i fiksuar në shtangetë, duke garantuar stabilitet dhe funksionim të sigurt gjatë operimit të siparit.

4.3 Sipari

